

## RELACION

### PËR

## PROJEKT VENDIMIN “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMËTARE TË KËRKIMIT DHE TEKNOLOGJISË”

Qëllimi i këtij projektvendimi është të krijojë kuadrin ligjor për ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit dhe Teknologjisë (AKKT), si një institucion publik, me statusin e personit juridik, në varësi të Këshillit të Ministrave.

Krijimi i AKKT bëhet në kuadër të reformës së kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik që ka ndërmarrë kjo qeveri. Kjo reform është një ndër prioritetet e qeverisë dhe synon në thelb ndërtimin e një sistemi modern të shkencës, fuqizimin e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik si dhe integrimin e tyre me arsimin e lartë.

Në vijim disa argument mbi domosdoshmërinë e ngritjes së AKKT, përvojat e vendeve të tjera në fushën e politikëbërjes, promovimit dhe manaxhimit të kërkimit dhe zhvillimit (k & zh) si dhe disa shpjegime mbi misionin, detyrat dhe organizimin e AKKT.

### 1. Domosdoshmëria e Krijimit të Agjencisë

Nevoja e krijimit lidhet me argumentet e mëposhtme:

- a) **Shqipëria po rrit me shpejtësi investimet për shkencën dhe teknologjinë dhe kjo kërkon një manaxhim më të shpejtë, më eficient dhe më profesional të fondeve.**

Deri më 2005, shqipëria ishte vendi europian me prapambejen më të madhe në fushën e “investimit për të ardhmen”, kur është fjala për investimin për inovacionin, kërkimin dhe zhvillimin teknologjik. Në këtë të fundit, teknologjitë e reja, vecanërisht IT, bioteknologjia, energjia e rinovueshme, bioenergja, nanoteknologjia, etj, janë në rend të ditës (Programi kuadër VII i BE për Kërkimin dhe Zhvillimin). Në rastin e vendit tonë investimi edhe për shkencat e mirëfillta shqiptare përbën prioritet. Përvoja ka treguar se vende që kanë investuar me përparësi në kërkim dhe inovacion kanë edhe ritmet më të larta të zhvillimit ekonomik – shoqëror. Cdo vonesë në promovimin dhe investimet në këtë fushë bëhet kërcënuese dhe penguese për zhvillimin tërësor, ekonomik shoqëror të vendit.

- b) **Shqipëria ka mundësi të përfitojë më shumë fonde nga programet e BE, vecanërisht nga FP7, bashkëpunimi bi-dhe multilateral.**

Kërkimi, zhvillimi dhe teknologjia kërkojnë investime të mëdha dhe të shpejta që për nga vëllimi I tyre nuk mund të përballohen vetëm nga buxheti. Një burim shumë i rëndësishëm financimi, madje për disa fusha parësore, janë programet dhe projektet e BE. Mungesa e strukturave funksionale, efikase për sektorë / resorte kaq të rëndësishme ka bërë që ne të kemi akses të pamjaftueshëm në shumë programe të BE që ofrojnë shumë mundësi mbështetjeje financiare dhe institucionale.

- c) **Kërkimi, zhvillimi, teknologjia dhe inovacioni I përkasin si resorte jo vetëm MASH, por edhe shumë ministrive të tjera si Min. Ekonomisë, Min. Bujqësisë, Min. Punëve Publike, Min. Mjedisit, Min. Shëndetësisë dhe Min. Turizmit.**

Pra kemi të bëjmë me një problematikë ndërministrore, e cila kërkon edhe një koordinim nga një strukturë ndërministrore nën mbikqyrjen direkte të Kryeministrit. Në këtë vështrim kërkimi, teknologjia dhe inovacioni duhet të bëhen çështje për të cilën Kryeministri është gjithnjë i informuar mirë.

- d) **MASH nuk mund të përballojë menaxhimin e kërkimit dhe zhvillimit, sepse, nga njëra anë, nuk ka akses institucional koordinues për ministrinë e tjera dhe nga ana tjetër, asaj do ti duhej të përballonte një vlersim të madh pune në menaxhimin të përditshëm. MASH I takon politikëbërja e lidhur me shkencën. Përvoja 10 – vjecare e ka**

vërtetuar më së miri pamundësinë e MASH për të përballuar menaxhimin e kërkimit. Rritja e ndjeshme e fondit për shkencën në 3 vitet e fundit u shoqërua me mosrealizime të theksuara, cka vërteton pamundësinë e kësaj srukure të MASH për ta administruar me efikasitet këtë fond. Për vitin 2009 Fondi për Shkencën arrin në rreth 6 milion USD, gati 2 herë më I madh se sa ai I këtij viti. Mosrealizimi I këtij fondi ikushton shtrenjtë vendit pasi frenon zhvillimin e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit.

- e) **Duhet u rritur pjesëmarrja e sektorit privat në mbështjen financiare të kërkimit dhe zhvillimi, e cila der tani është inekzistente.** Kjo jo vetëm për shkak se biznesi shqiptar ka qenë në hapa e para të zhvillimi të tij, por edhe për faktin se deri tani nuk ka ekzistuar asnjë strukturë institucionale ku biznesi ka qenë pjesëmarrës në vendimmarrje dhe ka ndjerë edhe detyrimin e kontributit për kërkimin, zhvillimin dhe teknologjinë. Duhet gjetur rrugë efikase për të rritur kontributin e sektorit privat për kërkimin dhe teknologjinë.
- f) **Duhet rritur pjesëmarrja e komunitetit akademik shkencor në vendimmarrjen e përdorimit të fondeve për K&ZH.** Praktika e të gjitha vendeve tregon se në promovimin e kërkimit, zhvillimit dhe teknologjisë, pjesa kryesore e këshillave vendimmarrëse, vlerësuese dhe monitoruese përbëhet nga përfaqësues direkt të komunitetit të shkencëtarëve. Deri tani kjo praktikë tek ne ka qenë shumë pak e zhvilluar dhe vendime janë marrë shpesh nga administratorët. Vetëm struktura e Agjencisë, konkretisht pjesëmarrja në shumicë në Këshillin Drejtues të Agjencisë, konkretisht pjesëmarrja në shumicë në Këshillin Drejtues të Agjencisë, e mundëson një pjesëmarrje reale të komunitetit akademik.
- g) **Duhet hapësira reale e mbështetjes me fonde / financimin e ideve që kanë shkencëtarët shqiptarë.** Një problem aktual është që drejtuesit e fakulteteve dhe universiteteve apo qendrave kërkimore nuk I krijojnë hapësira reale cdo shkencëtarit të paraqesë ide dhe koncepte shkencore, madje në shumë raste i frenojnë ata. Agjencia, duke pasur si parim kryesor mbështetjen e cdo projekti shkencor që vlerësohet nga ekspertët të pavarur për vlerat e tij shkencore, bën të mundur që cdo shqiptar që paraqet një ide me vlera shkencore, të realizojë të drejtën e tij legjitime për ta provuar / hulumtuar idenë e tij me lirinë e plotë akademike shkencore që I njeh Kushtetuta jonë dhe kuadri ligjor në fuqi.

## 2. Modelet e strukturave politikëbërëse për kërkimin, zhvillimin dhe teknologjinë

Në praktikën e shumë vendeve, politikëbërja për kërkimin, zhvillimin dhe teknologjinë është e përqendruar në një ministri ose strukturë të ngjashme me të në formën e një komiteti shtetëror. Një praktikë e tillë është zbatuar në vendin tonë në mandatin e parë 1992 / 96 si Komiteti i Shkencës dhe më pas, vetëm për një vit 1996/1997, si Ministri e Arsimit të Lartë dhe Kërkimeve Shkencore. Kjo haset jo vetëm në vende të mëdha por edhe në vende relativisht të vogla dhe lidhet me prioritetin e madh që i jepet kërkimit, zhvillimit dhe teknologjisë si lokomotiva e vërtetë e zhvillimit të një vendi. Por, ka edhe vende të tjera që politikëbërjen e kanë të shpërndarë në disa ministri dhe koordinimi realizohet direkt nën drejtimin e Kryeministrit. *Këtë model po ndjekim ne aktualisht, ku politikat e kërkimit, zhvillimit dhe teknologjisë hartohen nga disa ministri, si MASH, METE, MBUK, MPPTT, MMPAU, MSH, MTKRS dhe finalizohen nga Këshilli i Ministrave në formën e vendimeve dhe ligjeve.* Por aktualisht mungon një strukturë koordinuese pranë Kryeministrit ose Këshillit të Ministrave. Për rrjedhojë efektet janë akoma shumë të segmentuara. Zakonisht rolin e strukturës koordinuese e luajnë këshillat e politikave, që drejtohen nga Kryeministri dhe në të bëjnë pjesë disa ministra si dhe disa ekspertë nga komuniteti akademik – shkencor.

Ngritja e Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës ishte një hap I drejtë në drejtimin e duhur dhe ai mund të mbështesë mirë politikëbërjen në fushën e arsimit të lartë dhe të shkencës. Por ai, me formën përfundimtare që mori si organ këshillimor për arsimin e lartë dhe shkencën, nuk mund të luajë rol koordinues ndërministror dhe nuk mer vendime në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe teknologjisë.

## 3. Modelet e strukturave administruese e menaxhuese të kërkimit, zhvillimit dhe teknologjisë

Pothuaj në të gjitha vende, strukturat administruese e menaxhuese të kërkimit, zhvillimit dhe teknologjisë janë Fondacionet dhe në shumë pak raste Agjencitë Kombëtare.

Modelet e Fondacioneve janë përgjithësisht agjenci të pavarura në varësi të ekzekutivit. Ato zbatojnë politikat e zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë dhe, për rrjedhojë, menaxhojnë buxhetin (si grant) e destinuar për kërkimin

shkencor, zhvillimin teknologjik. Përvec këtij granti, fondacionet thithin fonde nga burimet e tjera, si programet internacionale (në këtë rast rëndësi të vecantë paraqet FP 7) si dhe nga sektori privat.

Në projektin e përgatitur është propozuar **modeli i Agjencisë, si një agjenci publike autonome, në varësi të Këshillit të Ministrave**. Agjencia menaxhon fondet e buxhetit të shtetit, të programeve internacionale si dhe të sektorit privat të destinuar për kërkim, zhvillim dhe teknologji.

### **Misioni i Agjencisë**

Agjencia ka si mision promovimin e kërkimit shkencor dhe zhvillimit teknologjik (më tej: kërkim dhe zhvillim – K & Zh) në vend, zbatimin e politikave të qeverisë dhe strategjisë së K & ZH si dhe koordinimin e këtyre veprimtarive në shkallë vendi.

### **Detyrat e Agjencisë**

Në mënyrë që të realizojë misionin e përcaktuar në nenin 2, Agjencia kryen detyrat kryesore të mëposhtme:

- a) Promovon zhvillimin të K & Zh;
- b) Koordinon dhe monitoron veprimtaritë e K & ZH në shkallë vendi;
- c) Mbështet teknikisht për të gjitha institucionet në fushën e investimeve në fushën e K&ZH;
- d) Promovon ngritjen e strukturave për K&ZH në të gjitha nivelet.
- e) Promovon bashkëpunimin me sektorin privat në fushën e K&ZH;
- f) Promovon, mbështet teknikisht, koordinon dhe monitoron bashkëpunimin bi –dhe multilaterale me BE, vendet e vecanta dhe organizatat e huaja në fushën e K & ZH;
- g) Bashkëpunon me ministritë dhe institucionet e tjera për përgatitjen e strategjisë së K &ZH;
- h) Bashkëpunon me institucionet ekzekutive dhe legjislativin si edhe institucionet e tjera në përmirësimin dhe plotësimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe nënligjor për K & Zh;
- i) Përkujdeset për K & ZH në fushat më kryesore për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare;
- j) Implementon politikat e qeverisë për mbështetjen me përparësi të shkencëtarëve më të kualifikuar dhe grupeve kërkimore mësimore më të sukseshme në K & Zh;
- k) Zbaton politikat e qeverisë për nxitjen e pjesëmarrjes së studentëve dhe shkencëtarëve të rinj në K&ZH
- l) Zbaton politikat nxitëse për kthimin e trurit dhe rritjen e angazhimit të diasporës inelektuale shqiptare në arsim, K & Zh dhe zhvillimin e gjithanshëm të vendit;
- m) Krijon dhe pasuron në mënyrë të vazhdueshme bazën e të dhënave, analizave dhe dokumentacionit të sistemit të K & Zh

**Pjesëmarrja e fianancuesve në vendimmarrje** realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në **Bordin Drejtues të Agjencisë**, i cili është **organi vendimmarës i Agjencisë**. Bordi përbëhet nga:

- 4 përfaqësues të përzgjedur nga komuniteti akademik shkencor;
- 4 përfaqësues të dërguar nga ekzekutivi;
- Kryetari i Dhomës së Tregëtisë dhe Industrisë;

Funksionet kryesore të Bordit janë si më poshtë:

- a) Përcakton objektivat e përgjithshme të veprimtarisë së Agjencisë;
- b) I propozon organit të emërtesës, buxhetin dhe miraton të ardhurat e Agjencisë;
- c) Miraton shpërndarjen e fondeve për fushat e ndryshme të shkencës, programet dhe marrëveshjet e bashkëpunimit për K & ZH;
- d) Vlerëson veprimtarinë e Agjencisë;
- e) Miraton raportin e veprimtarisë së Agjencisë që I dërgohet Këshillit të Ministrave dhe bëhet publik;
- f) I propozon Kryeministrit emërimin dhe shkarkimin e Drejtorit të Agjencisë;
- g) Përzgjedh drejtorët e departamenteve të Agjencisë;

- h) Miraton komisionet e fushave të shkencës në bazë të propzimeve sic parashikohet në pika 8, 9, 10 dhe 11 të këtij vendimi.

Drejtimi I përditshëm i Agjencisë realizohet nga Drejtori Ekzekutiv, I cili propozohet nga Bordi i Agjencisë dhe emërohet nga Kryeministri. Drejtori mbështetet nga Administrata e Agjencisë e përbërë prej 15 nëpunës me kualifikim të mirë, së paku master, dhe me njohuri shumë të mira në anglisht dhe në një gjuhë tjetër përfundimtare.

Drejtori harton raportin vjetor, i cili pasi miratohet nga Bordi i Agjencisë, i dërgohet Këshillit të Ministrave. Agjencia ka buxhet më vete. Te gjitha aktet ligjore ose nënligjore Agjencia i propozon përmes Kryeministrit ose Zëvendës Kryeministrit.

Agjencia mund të ngrihet si strukturë Brenda një viti dhe të fillojë veprimtarinë e saj të plotë në fillim të viti 2009. Ky do të ishte një sinjal shumë i rëndësishëm politik që jep Qeveria për realizimin e objektivave politike në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe teknologjisë.

**KRYEMINISTRI**

**SALI BERISHA**